



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE**

Nr. 1018/8 prot.

Tiranë, më 05.06.2025

VENDIM

Nr. 14, datë 05.06.2025

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) formularin e ankesës nr. 1018 Prot., datë 19.03.2025, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Nëpërmjet kërkesës datë 21.02.2025, ankuesi, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni si vijon:

1. Listën e kontratave me emrat e kompanive që kanë përfituar përjashtim nga TVSH-ja sipas ligjit nr. 97/2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” për programet e rindërtimit, për të cilat do të aplikohet përjashtimi nga TVSH për vitin 2020.
2. Listën e kontratave me emrat e kompanive që kanë përfituar përjashtim nga TVSH-ja sipas ligjit nr. 97/2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” për programet e rindërtimit, për të cilat do të aplikohet përjashtimi nga TVSH për vitin 2021.
3. Listën e kontratave me emrat e kompanive që kanë përfituar përjashtim nga TVSH-ja sipas ligjit nr. 97/2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë

natyrore” për programet e rindërtimit, për të cilat do të aplikohet përjashtimi nga TVSH për vitin 2022.

4. *Listën e kontratave me emrat e kompanive që kanë përfituar përjashtim nga TVSH-ja sipas ligjit nr. 97/2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” për programet e rindërtimit, për të cilat do të aplikohet përjashtimi nga TVSH për vitin 2023.*
5. *Listën e kontratave me emrat e kompanive që kanë përfituar përjashtim nga TVSH-ja sipas ligjit nr. 97/2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” për programet e rindërtimit, për të cilat do të aplikohet përjashtimi nga TVSH për vitin 2024.*

Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it datë 06.03.2025, ka kthyer përgjigje duke cituar ndër të tjera se: *“...Në lidhje me kërkesën ku kërkohet informacion lidhur me listën e kontratave me emrat e kompanive që kanë përfituar përjashtim nga TVSH-ja sipas ligjit nr.97/2019 Administrata Tatimore bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 24 të tij ka përcaktuar shprehimisht autoritetet të cilave ka detyrimin e vënies në dispozicion të informacionit tatimor lidhur me tatimpaguesin, si dhe rastet e dhënies së këtij informacioni. Ndërsa në nenin 25 “Konfidencialiteti”, të ligjit të sipërcituar parashikohet se: “Nëpunësit dhe punonjësit e administratës tatimore, qendrore dhe vendore, ruajnë konfidencialitetin e të dhënave tatimore dhe financiare të tatimpaguesit që i kanë siguruar gjatë kryerjes së detyrës.”*

Të dhënat e kërkuara përbëjnë të dhëna tatimore bazuar në nenin 31 “E drejta për konfidencialitetin e të dhënave”, pika 2 e ligjit të sipërcituar, ku përcaktohet se: “E dhënë tatimore dhe financiare është çdo informacion, i cili merret nga administrata tatimore gjatë ushtrimit të funksioneve, tek tatimpaguesit ose palët e treta”.

Në vijim të përgjigjes së sipërcituar, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi nuk i është vendosur në dispozicion lista e kontratave me emrat e kompanive që kanë përfituar përjashtim nga TVSH-ja sipas ligjit nr. 97/2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, për vitet 2020 – 2024, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”). Në përputhje me nenin 10, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 1018/1 Prot., datë 21.03.2025, kërkoi nga Autoriteti Publik, të rivlerësojë dhënien e informacionit në raport me vendimmarrjen e Komisionerit për raste të ngjashme.

Në vijim, Autoriteti Publik, me shkresën nr. 4977/1 Prot., datë 28.03.2025, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1018/2 Prot., datë 01.04.2025, ka sqaruar se: “...VKM nr. 143, datë 13.02.2020 “Për procedurat për lëshimin e autorizimit për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të furnizimit të mallrave dhe shërbimeve për qëllime të procesit të rindërtimit”, në nenin 4 përcakton se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen zyrtare dhe mban të përditësuar listën e subjekteve të rindërtimit, të cilat janë pajisur me autorizim përjashtimi nga TVSH-ja, ku pasqyrohen të dhënat identifikuese të tatimpaguesit, NIPT/NUIS-i, numri dhe data e lëshimit të autorizimit.

Sa më sipër cituar, kjo VKM përcakton qartë se cilat janë të dhënat që duhet të publikohen/shkëmbehen.

Për sa i përket kërkesës për informacion lidhur me listën e kontratave me emrat e kompanive, bëjmë me dije se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve disponon vetëm regjistrin me të dhënat e përcaktuara në nenin 4 të VKM-së, së sipërcituar (Emri i tatimpaguesit, NIPT/NUIS, numri dhe data e autorizimit të lëshuar), e cila mund të gjendet e publikuar dhe e përditësuar në faqen zyrtare të DPT-së.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se për kërkesat për informacion lidhur me të dhënat e tjera që nuk janë përcaktuar në nenin 4 të vendimit të sipërcituar dhe që përbëjnë të dhëna tatimore dhe financiare të tatimpaguesit, Administrata Tatimore bazuar në nenin 25 “Konfidencialiteti” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ka detyrimin e ruajtjes së konfidencialitetit të tyre. Në nenin 24 ky ligj ka përcaktuar shprehimisht autoritetet të cilave Administrata Tatimore ka detyrimin e vënies në dispozicion të informacionit tatimor lidhur me tatimpaguesin, si dhe rastet e dhënies së këtij informacioni.”

Ankuesi, pas përgjigjes së sipërcituar me e-mail-in datë 09.04.2025, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1018/3 Prot., datë 09.04.2025, ka vijuar me ankimin me pretendimin se: “...emri i tenderit ose kontrata publike për të cilën operatorët ekonomikë kanë kryer shërbime dhe janë të përjashtuar nga TVSH-ja gjendet si informacion te Vendimi nr. 804, datë 30.9.2020, i cili është vendimi i fundit për Vendimin Nr. 143, datë 13.2.2020 për subjektet e përjashtuara nga TVSH-ja në programin e Rindërtimit.

Në Vendimin nr. 804, datë 30.9.2020 shkruhet se për qëllime të zbatimit të përjashtimeve të mësipërme, subjektet e përcaktuara për Rindërtimin, të këtij vendimi, duhet të jenë të autorizuar nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, për t’u pajisur me autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja dhe duhet të paraqesin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dokumentacionin e mëposhtëm (neni 4):

b) Marrëveshjen kuadër, që kanë lidhur me njësinë zbatuese për secilën procedurë prokurimi publik të programit të rindërtimit, sipas parashikimeve në ligjin e fushës, në rastin e ndërtuesit/kontraktorëve;

dh) Kontratën e lidhur me ndërtuesin/kontraktorin, në rastin e furnizuesve të mallrave ose të shërbimeve që furnizojnë direkt ndërtuesit e autorizuar, kontraktorë/nënkontraktorë. Pra, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve e ka informacionin se për cilët tendera këto subjekte përjashtohen nga TVSH-ja”

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit me shkresën nr. 1018/4 Prot., datë 14.04.2025, kërkoi nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me vijimin e sipërcituar, vlerësimin përfundimtar, si dhe sqarime për disponimin e informacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës me nr. 4977/3 Prot., datë 22.04.2025, regjistruar me nr. 1018/6 Prot., datë 25.04.2025, rikonfirmoi qëndrimin si më sipër trajtuar, duke sqaruar gjithashtu se: *“...Për sa i përket kërkesës për informacion lidhur me listën e kontratave me emrat e kompanive, bëjmë me dije se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve disponon vetëm regjistrin me të dhënat si emri i tatimpaguesit, NIPT/NUIS, numri dhe data e autorizimit të lëshuar, të mbajtur sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 4 të VKM-së, e cila mund të gjendet e publikuar dhe e përditësuar në faqen zyrtare të DPT-së. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve thekson se nuk disponon asnjë regjistër me të dhëna të tjera...”*

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin parashikohet se: *“...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”,* bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nëpërmjet shkresës nr. 1018/7 prot., datë 02.05.2025, Komisioneri ftoi Autoritetin Publik në një seancë dëgjimore. Seancë kjo e cila u zhvillua në datën 07.05.2025, me prezencën e përfaqësuesve të Autoritetit Publik, si dhe ankuesit.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesën fillestare, si dhe vijimin e saj.

Gjithashtu, përfaqësuesit e Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimin e mbajtur në aktet shkresore të sipërcituara, si dhe deklaruan ndër të tjera se informacioni objekt shqyrtimi disponohet por jo në formatin e kërkuar. Pra, informacioni nuk disponohet në formën e një liste. Konkretisht përfaqësuesit deklaruan se kontratat dhe dokumentet shoqëruese disponohen nga Autoriteti Publik, por ato janë shumë voluminoze.

Ndërkohë, lista që disponohet është ajo e publikuar në zbatim të VKM-së nr. 143, datë 13.02.2020 “Për procedurat për lëshimin e autorizimit për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të furnizimit të mallrave dhe shërbimeve për qëllime të procesit të rindërtimit”, si një detyrim i cili rrjedh nga kjo VKM.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik, për ankesën objekt shqyrtimi, nuk janë në përputhje me dispozitat e LDI.

Në nenin 2, të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njërive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.*

Në kuptim të këtij parashikimi, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”*

Në pikën 1 të nenit 3, LDI përcakton se: *“1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.”*

Refuzimi i dhënies së informacionit, fillimisht mbi bazën e nenit 24 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është i gabuar, pasi ky ligj nuk parashikon ndalimin e dhënies së informacionit tatimor për subjekte të tjera mbi bazën e LDI.

Gjithashtu parashikimet e nenit 24 janë të zbatueshme për ato raste kur informacioni nuk përbën informacion publik në kuptim të LDI dhe dhënia e tij kryhet në një kontekst të caktuar siç është rasti i një procesi gjyqësor civil apo penal, kontrolli i ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në kuadër të veprimtarisë së tij, etj.

Kërkesa për informacion, në rastin konkret, lidhet me dokumenta që përmbajnë informacion për procesin e përfitimit të autorizimit për përjashtimin nga TVSH-ja për procesin e rindërtimit sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.143, datë 13.2.2020 “Për procedurat për lëshimin e autorizimit, për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të furnizimit të mallrave e shërbimeve, për qëllime të procesit të rindërtimit”, i ndryshuar, informacion ky i cili lidhet me efektet në buxhetin e shtetit dhe rrjedhimisht përbën një interes për publikun.

Ndërkohë, LDI rregullon dhënien e aksesit në informacionin publik për çdo person të interesuar. Ky ligj, në nenin 17 të tij përcakton dhe rastet kur dhënia e informacionit jepet në mënyrë të kufizuar. Në këto raste, Autoriteti Publik duhet të tregojë qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që refuzohen, si dhe në bazë të cilës pikë të nenit 17 bëhet ky refuzim. Nga verifikimi i përgjigjes së Autoritetit Publik, nuk rezulton të jetë argumentuar refuzimi i kërkesës në përputhje me këtë nen.

Lidhur me argumentin e parashtruar në seancën dëgjimore nga përfaqësuesit e Autoritetit Publik se dokumentacioni i disponuar është voluminoz, Komisioneri vlerëson se ky qëndrim nuk vjen në përputhje me qëllimin e LDI, i cili është garantimi i njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Komisioneri, megjithëse mirëkupton situatën e pretenduar nga Autoriteti Publik, për shkak të punës voluminoze, nuk përjashton në asnjë moment këtë të fundit nga detyrimi për të ushtruar veprimtarinë e tij në lidhje me transparencën.

Lidhur me pretendimin e Autoritetit Publik sipas të cilit nuk ekziston një listë sipas kërkesës për informacion, por duhet prodhuar një dokument i ri, Komisioneri konstaton se autoriteti ka pranuar disponimin e informacionit, por jo në formatin e kërkuar.

Kjo, sipas detyrimit që ky autoritet ka referuar, konkretisht nenit 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.143, datë 13.2.2020 “Për procedurat për lëshimin e autorizimit, për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të furnizimit të mallrave e shërbimeve, për qëllime të procesit të rindërtimit”, i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *“Për qëllime të zbatimit të përjashtimeve të mësipërme, subjektet e përcaktuara në nenin 3, të këtij vendimi, duhet të jenë të autorizuar nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Për t’u pajisur me autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja, paraqesin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dokumentacionin e mëposhtëm:*

a) Kërkesën me shkrim, së cilës i bashkëlidhet një fotokopje e certifikatës së NIPT/NUIS-it;

b) Marrëveshjen kuadër, që kanë lidhur me njësinë zbatuese për secilën procedurë prokurimi publik të programit të rindërtimit, sipas parashikimeve në ligjin e fushës, në rastin e ndërtuesit/kontraktorëve;

c) Marrëveshjen e bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe donatorit, në rastet kur ndërtuesi, subjekt i rindërtimit, është përcaktuar nga donatori që ka marrë përsipër procesin e ndërtimit, në përputhje me programin e rindërtimit;

ç) Preventivin e punimeve, mbi bazën e të cilit janë përzgjedhur fitues për kontratat publike për punime/shërbime ndërtimi, në kuadër të zbatimit të procesit të rindërtimit, shoqëruar kjo me listën e detajuar të materialeve që do të përdoren në procesin e ndërtimit, në rastin e ndërtuesit/nënkontraktorëve;

d) Shfuqizuar;

dh) Kontratën e lidhur me ndërtuesin/kontraktorin, në rastin e furnizuesve të mallrave ose të shërbimeve që furnizojnë direkt ndërtuesit e autorizuar, kontraktorë/nënkontraktorë.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga data e dorëzimit të dokumentacionit, shqyrton kërkesën e paraqitur nga subjektet e rindërtimit. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, njoftohet kërkuesi për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e dokumentacionit brenda një afati pesëditor. Bazuar në rezultatet e shqyrtimit, kur përmbushen kërkesat e përcaktuara dhe është plotësuar dokumentacioni i sipërpërmendur, drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga paraqitja e kërkesës, lëshon autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja për subjektet e rindërtimit. Një kopje e autorizimit, së bashku dokumentacionin shoqëruar i përcillet drejtorisë rajonale tatimore përkatëse, që ka në administrim tatimpaguesin, subjekt të rindërtimit...”

Nga shpjegimi i dhënë në seancë dëgjimore nga përfaqësuesit e Autoritetit Publik, Komisioneri konstaton se ka pasur një ngatërresë mbi informacionin që duhet të bëhet

publik në zbatim të detyrimeve që rrjedh nga VKM-ja e sipërcituar, si dhe detyrimit për t'a vendosur atë në dispozicion në respektim të dispozitave të LDI.

Në këto kushte, bazuar në pikën 2, të neni 2 të LDI, ku parashikohet se: *“Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”*, Komisioneri vlerëson se, informacioni mbi kontratat përkatëse, përbën informacion publik dhe bazuar në dispozitat e sipërcituara duhet të vendoset në dispozicion të kërkuarit/ankuesit në formatin e zotëruar, duke mbajtur në konsideratë kufizimet sipas nenit 17 të LDI.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike.

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së z. _____, me nr. 1018 Prot., datë 19.03.2025 (vijuar me nr. 1018/5 Prot., datë 24.04.2025), ndaj Autoritetit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit, në formën e zotëruar, sipas kërkesës për informacion datë 21.02.2025, konkretisht:
(1. Listën e kontratave me emrat e kompanive që kanë përfituar përjashtim nga TVSH-ja sipas ligjit nr. 97/2019 *“Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”* për programet e rindërtimit, për të cilat do të aplikohet përjashtimi nga TVSH për vitin 2020. 2. Listën e kontratave me emrat e kompanive që kanë përfituar përjashtim nga TVSH-ja sipas ligjit nr. 97/2019 *“Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”* për programet e rindërtimit, për të cilat do të aplikohet përjashtimi nga TVSH për vitin 2021. 3. Listën e kontratave me emrat e kompanive që kanë përfituar përjashtim nga TVSH-ja sipas ligjit nr. 97/2019 *“Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë*

natyrore” për programet e rindërtimit, për të cilat do të aplikohet përjashtimi nga TVSH për vitin 2022. 4. Listën e kontratave me emrat e kompanive që kanë përfituar përjashtim nga TVSH-ja sipas ligjit nr. 97/2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” për programet e rindërtimit, për të cilat do të aplikohet përjashtimi nga TVSH për vitin 2023. 5. Listën e kontratave me emrat e kompanive që kanë përfituar përjashtim nga TVSH-ja sipas ligjit nr. 97/2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” për programet e rindërtimit, për të cilat do të aplikohet përjashtimi nga TVSH për vitin 2024), duke respektuar kufizimet në përputhje me pikën 6, të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, brenda datës 13.06.2025.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 05.06.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi